



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

SYLLABUS i Lëndës Kontrolli dhe auditimi i brendshëm

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit - KF
Titulli i lëndës:	Kontrolli dhe auditimi i brendshëm
Niveli:	Bachelor
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II (Semestri IV)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	<i>Roli i auditorit të brendshëm në një organizatë (private apo publike) është të ofroj siguri të pavarur në lidhje me efektivitetin e menaxhimit të rrezikut, qeverisjes dhe proceseve të kontroleve të brendshme. Në këtë lëndë trajtohen funksioni i auditimit të brendshëm, menaxhimi i rrezikut dhe proceset biznesore, parimet e udhëheqjes dhe menaxhimit standardet e obligueshme për profesionin e auditimit të brendshëm dhe rrezikun, mjetet dhe teknikat e auditimit të brendshëm, rreziku nga mashtrimi dhe kontrollet edhe ndikimet që kanë auditimi i pasqyrave financiare, operacional dhe i përputhshmërisë në vlerësimin e gjendjes reale të një kompanie</i>
Qëllimet e lëndës:	<i>Qëllimi i kësaj lënde është që kandidatët të fitojnë njohuri të thelluara lidhur me: standardet ndërkombëtare të auditimit të</i>

	brendshëm përfshirë edhe kodin e etikës për profesionistët e kësaj fushe, politikat dhe procedurat e kontrollit të brendshëm të entiteteve dhe rrezikun e ndërlidhur me mos-zbatimin e tyre, mjetet dhe teknikat e aplikuara gjatë kryerjes së angazhimeve të auditimit të brendshëm; funksionin e departamentit të auditimit të brendshëm në entitete të ndryshme, kryerjen e suksesshme të auditimeve të brendshme individuale në entitet të ndryshme, vlerësimin e rrezikut nga mashtrimet dhe kontrollet relevante në entitete të ndryshme		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: • Kuptojë rolin e auditimit të brendshëm; • Kuptojë dhe aplikojë standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të lëshuara nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm (IIA); • Kuptojë dhe aplikojë mjetet dhe teknikat e nevojshme për kryerjen e suksesshme të angazhimeve në fushën e auditimit të brendshëm; • Kuptojë dhe aplikojë teknikat për vlerësimin e rrezikut nga mashtrimet në fushën e auditimit të brendshëm; • Aplikojë standardet adekuate për raportimin e rezultateve të auditimit të brendshëm; • Aplikojë njohuritë e tyre në fushën e menaxhmentit financiar, qeverisjes korporatave, udhëheqjes dhe mjedisit ndërkombëtarë të bizneseve;		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Detyra shtëpie	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	3	3
Koha e studimit vetanak të studentit	1	15	15

Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Totali			125

Metodologjia e mësimdhënies:	• Prezantimi i temës mësimore në Power Point • Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjësuar
Metodat e vlerësimit:	• Aktiviteti në ligjëratat 0-10% • Raste të studimit 0-10% • Kollokviumi i parë: 0-40% • Kollokviumi i dytë: 0-40% • Provimi përfundimtar 0- 80%

Literatura	
Literatura bazë:	• Bazat e Auditimit të Brendshëm dhe Praktika e Auditimit të Brendshëm nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm në Amerikë (përkthyer në gjuhën shqipe), Botues: John Wiley & Sons, Inc. ISBN 978-1-119-24217-8 dhe ISBN 978-1-119-24207-9 • Berisha, Nexhmije: Kontrolli i brendshëm dhe auditimi , Prishtinë 2015
Literatura shtesë:	• Pickett, KH Spencer. The internal auditing handbook. John Wiley & Sons, 2010 IIA (Insituti i Auditorëve të Brendshëm), Standardet Ndërkombetare të Auditimit të Brendshëm

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Pasqyrë përmblendhëse e përmbajtjes së lëndës – Ligjeratë hyrëse
Java e dytë:	Çka është auditimi i brendshëm?
Java e tretë:	Auditimi i brendshëm konceptet dhe funksionet
Java e katërt:	Kodi i etikës në Auditimin e brendshëm

Java e pestë:	Standardet Ndërkombëtare
Java e gjashtë:	Tipet dhe Komponentët e kontrollit të brendshëm
Java e shtatë:	Testi I
Java e tetë:	Marrëdhëniet në mes kontrollit dhe auditimit të brendshëm
Java e nëntë:	Procesi i auditimit
Java e dhjetë:	
Java e njëmbëdhjetë:	Auditimi i brendshëm në sektorin public
Java e dymbëdhjetë:	Dëshmitë, provat dhe dosjet e auditimit dhe kontrollit
Java e trembëdhjetë:	Raportimi i Rezultateve të Testimit për Auditorin Përgjegjës
Java e katëmbëdhjetë:	Mjetet dhe Teknikat e Kompjuterizuara të Auditimit
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi II

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.</i> • Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore; • Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore; • Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim; • Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit; • Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale. • Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.